



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

## **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

# **MIRËMBAJTJE NDËRTESTASH**

**Niveli i tretë i KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit III të KEK<sup>2</sup>**

**B6-III-16**

**Tiranë, Tetor 2016**

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	"MIRËMBAJTJE NDËRTESESASH"			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK,	B6-III-16
<b>Qëllimi:</b>	<p>Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin "Mirëmbajtje ndërtesash", niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është "zhvillimi i personalitetit të individit për të punuar në një mjedis të ndërtuar banesash të populluara nga banorë me larmi grup moshash, prejardhjeje gjeografike, arsimore, fetare, gjuhësore, shëndetësore, gjinore etj. dhe në përshtatje me të, të jenë të aftë për t'u punësuar e përballur me mjeshtëri në veprime që lidhen drejtpërdrejt me mirëmbajtjen e ndërtesave dhe mirëqenien e përdoruesve (banorëve) të tyre".</p>			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	<p>Në institucionet që ofrojnë kualifikim profesional në "Mirëmbajtje ndërtesash" niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kanë mbaruar kualifikimin profesional "Ndërtim", niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK;</li> <li>• janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli.</li> </ul>			
<b>Mundësitë e cilësimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional "Mirëmbajtje ndërtesash", niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të këtij niveli si punonjës i kualifikuar në këtë profil profesional, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit që pas përfundimit të nivelit III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, t'i drejtohet tregut të punës për t'u punësuar në kompani ndërtimi, si dhe në sipërmarrje vetjake duke punësuar specialistë të tjerë në veprimtari të mirëmbajtjes së ndërtesave e njësisve më të ndërlikuara të banimit, shërbimit apo rasteve të gërshetuara.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar), për të fituar të drejtën e diplomës së "Maturës Shtetërore Profesionale", me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
<b>Data e validimit</b>				
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>	Nuk ka			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

## NJOHURI

Individi duhet të dijë:

### Legjislacioni

- Të përshkruajë legjislacionin mbi administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të punës, për të drejtat dhe detyrimet e punëdhënësit dhe të punëmarrësit.
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të mbrojtjes së mjedisit për një zhvillim të qëndrueshëm;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit nga shkaqe të ndryshme, të tilla si: shkarkimet e gazrave të dëmshëm në ajër, shkarkimet e lëngjeve e të ujërave të ndotura (infektuara) në mjedise të hapura, të lëndëve të ngurta të dëmshme gjatë ndreqjeve etj.;
- Të përshkruajë masat që duhen marrë dhe pajisjet e nevojshme për shmangien e pasojave të dëmshme të gazrave, ujërave të ndotura dhe mbetjeve të ngurta që janë të dëmshme për shëndetin dhe mjedisin;
- Të përshkruajë veprimet e nevojshme që duhen kryer për dhënien e ndihmës së shpejtë;

### Organizimi i punës dhe sipërmarrje

- Të përshkruajë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;
- Të përshkruajë konceptin e normimit e punës në përgjithësi, kohët kryesore dhe ndihmëse të punëve të mirëmbajtjes në ndërtim, pastrim, kopshtari, riparime, etj.;
- Të përshkruajë elementet e përcaktimit të çmimit të shërbimit apo procesit të mirëmbajtjes (koston e përcaktuar, kohën e kryerjes, sasinë e kërkuar, çmimin/ofertën e tregut për atë mall ose shërbim, cilësitë ose veçoritë e tij, kushtet për mirëmbajtjen dhe sigurimin e materialeve etj.).
- Të interpretojë llojet dhe çmimet e materialeve kryesore dhe atyre ndihmëse që përdoren, sipas veçorisë së tyre për mënyrën e furnizimit, afatin dhe ciklin e përdorimit, vëllimin dhe mënyrën e magazinimit të tyre etj.
- Të përshkruajë mënyrën e përdorimit për pajisjet, elektrike dhe hidro/mekanike që duhet të mirëmbahen periodikisht nëpërmjet manualit të mirëmbajtjes përkatësisht për secilën pajisje;
- Të rendisë kërkesat për blerje të ndryshme veglash e pajisjesh të vogla ndërtimi e kopshtarie, pastrimi, dezinfektimi, etj.;
- Të përshkruajë organizimin e punës në mënyrë ergonomike;
- Të përshkruajë trasetë e rrjeteve inxhinierike për instalimet hidrosanitare – ngrohje -

ventilim; instalimet elektrike – telefonike – telekabllore – internet; instalimet (ose pajisjet) mekanike dhe për gjelbërimin;

#### **Punime murature dhe suvatimi**

- Të përshkruajë llojet dhe hapat e ndërtimit të mureve me tulla dhe tulla speciale, kartonxhes;
- Të përshkruajë llojet e materialeve dhe hapat e suvatimit të mureve e tavaneve të brendshme e të jashtme.

#### **Punime shtrimi dysHEMEJE E VESHJE MURI**

- Të përshkruajë llojet dhe hapat e ndërtimit të nënshtresave të katit përdhe dhe të bodrumit për nivele të ndryshme të ujërave nëntokësore;
- Të përshkruajë hapat e realizimit të shtresës niveluese të dyshemesë;
- Të përshkruajë llojet dhe hapat e realizimit të dyshemeve me copa/me fuga me lëndë të ndryshme ndërtimi (copa guri, pllaka guri, tulla, pllaka betoni, pllaka çimentoje e granili, pllaka qeramike, pllaka graniti e mermeri, mozaikë me copa mermeri, pllaka mozaikë me copa mermeri dhe tesarina) dhe me mënyra të ndryshme shtrimi;
- Të përshkruajë llojet dhe hapat e realizimit të vendosjes së pragjeve të dyerve dhe plintusave;
- Të përshkruajë llojet dhe hapat e realizimit të shtrimit të dyshemeve me materiale prej druri dhe ato speciale;
- Të përshkruajë llojet dhe hapat e realizimit të veshjes së mureve të mjediseve të brendshme të banimit;
- Të përshkruajë llojet dhe hapat e realizimit të veshjes së bazamakëve të shkallëve, korimanove, davancave, shpatullave të dyer-dritareve dhe parapeteve;
- Të përshkruajë llojet dhe hapat e realizimit të veshjes së mureve të jashtme (fasadave) me materiale dhe teknologji të ndryshme;

#### **Punime konstruksionesh prej betoni dhe betoni të armuar**

- Të përshkruajë llojet dhe hapat e realizimit të dyshemeve monolite;
- Të rendisë llojet e konstruksioneve mbajtëse të ndërtesave;
- Të përshkruajë llojet e betoneve dhe të armaturës së hekurit që përdoren sipas llojit të konstruksionit prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë elementet konstruktive përbërëse të skeletit prej betoni të armuar;
- Të interpretojë tabelën e sipërfaqes së armaturës së hekurit (**Fa**) për elemente të ndryshme konstruktive prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë llojet dhe mënyrën e realizimit të konstruksioneve prej betoni të armuar të parapërgatitura.
- Të përshkruajë mënyrat e përpunimit të armaturës së hekurit që përdoret për konstruksione prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë hapat e lidhjes së armaturës së hekurit për elemente konstruktive prej betoni të armuar: themele të veçuar, mure, shtylla, trarë, pllaka e shkallë;
- Të përshkruajë hapat e lidhjes së armaturës së hekurit për pllaka gjysmë monolite prej betoni të armuar;
- Të përshkruajë mënyrat dhe makineritë e përgatitjes dhe transportit të betonit.;
- Të përshkruajë hapat për betonimit të themeleve, mureve, shtyllave, trarëve, pllakave dhe shkallëve;

- Të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes së strukturave pas betonimit;
- Të përshkruajë hapat e heqjes së kallëpeve të skeletit prej betoni të armuar;

### **Punime patinimi e bojatisje**

- Të përshkruajë llojet e materialeve dhe hapat e patinimit të mureve;
- Të përshkruajë llojet e materialeve dhe teknologjinë e bojatisjes së mureve të brendshme e të jashtme, dhe të sipërfaqeve prej druri e metali;

### **Punime të thjeshta elektrike**

- Të shpjegojë nocionet bazë të elektroteknikës (rryma, tensioni, fuqia, energjia);
- Të përshkruajë kodin e ngjyrave të instalimeve elektrike;
- Të lexojë shenjat konvencionale të instalimeve elektrike;
- Të dallojë rrugët e kalimit të linjave të instalimeve elektrike;
- Të dallojë rrugët e instalimit të ndriçimit të shkallës, citofonisë, kamerave dhe të mbrojtjes nga zjarri;
- Të përshkruajë mënyrën e funksionimit dhe kontrollit të kamerave;
- Të përshkruajë mënyrën e vendosjes dhe tipat e elektropompave dhe ashensorit;
- Të përshkruajë defektet e mundshme në elektropompa dhe ashensor.
- Të përshkruajë afatet e kolaudimit dhe të kontrollit të elektropompave dhe ashensorit.
- Të shpjegojë rolin e gjeneratorit dhe UPS.
- Të shpjegojë rolin e panelit të matjes së energjisë dhe të mbrojtjes së instalimeve elektrike;
- Të përshkruajë masat mbrojtëse për mosrënien nën tension në instalimet elektrike.
- Të interpretojë rregullat për dhënien e ndihmës së parë për personat që goditen nga rryma elektrike.

### **Punime të thjeshta hidraulike e mekanike**

- Të dallojë sistemet e rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë dhe kanalizimit të një ndërtese;
- Të përshkruajë kodin e ngjyrave të instalimeve të rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë dhe kanalizimit;
- Të dallojë shenjat konvencionale të pajisjeve hidrosanitare, të ngrohjes dhe ventilimit si dhe të materialeve për rrjetin e instalimeve përkatëse;

### **Punime për mirëmbajtje e riparime të ndërtesës**

- Të përshkruajë hapat për riparimin e hidroizolimit të tarracës, çatisë dhe ullukëve horizontalë dhe vertikalë;
- Të përshkruajë hapat për riparimin e mureve të mjediseve të përbashkëta (parapet shkalle dhe tarrace, kafaz shkalle, fasade, rrethuese etj.);
- Të përshkruajë hapat për riparimin e suvatimit të tavanit të kafazit të shkallëve (tarracë, rampa dhe sheshpushime);
- Të përshkruajë hapat për riparimin e suvatimit të mureve të mjediseve të përbashkëta (parapet shkalle dhe tarrace, kafaz shkalle, fasadë, rrethuese etj.);
- Të përshkruajë hapat për riparimin e bazamakëve të shkallëve dhe të davancaleve të parapetit të tarracës dhe të daljeve të ndryshme në tarracë;
- Të përshkruajë hapat për riparimin e dyshemeve të mjediseve të përbashkëta (kafazi i shkallëve në kate dhe sheshpushime, si dhe në tarracë);

- Të përshkruajë hapat për riparimin e trotuarëve dhe të oborreve të shtruar.
- Të përshkruajë hapat për bojatisjen e mjediseve të përbashkëta të brendshme dhe të jashtme, prej lëndësh të ndryshme;
- Të përshkruajë hapat për mirëmbajtjen e pusëtës së kanalizimeve të ndërtesës.

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Individi duhet të jetë i aftë:

### **Aspekte të përgjithshme të mirëmbajtjes së ndërtesave**

- Të hartojë kërkesat për blerje të ndryshme veglash e pajisjesh të vogla ndërtimi e kopshtarie, pastrimi, dezinfektimi etj.;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në punë;
- Të përzgjedhë materialet e nevojshme dhe mjetet e punës për punime të ndryshme në ndërtim;
- Të përdorë makineritë, veglat dhe instrumentet në punimet të ndryshme në ndërtim;
- Të pastrojë dhe mirëmbajë mjetet dhe makineritë e punës gjatë punimeve të ndryshme në ndërtim;
- Të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Të vlerësojë potencialin personal (aftësitë personale, sociale dhe për biznes, njohuritë e mëparshme..) për të shfrytëzuar avantazhin konkurrues;
- Të demonstrojë aftësi udhëheqëse në situata të ndryshme;
- Të sigurojë burimet e duhura dhe të marrë përgjegjësinë për t'u kujdesuar për to;

### **Punime murature dhe suvatimi**

- Të ndërtojë mure me tulla të llojeve të ndryshme për një fragment planimetrie;
- Të ndërtojë kanale të tymit, ventilimit, korniza arkitektonike në mure tulle dhe puseta me mur tulle;
- Të suvatojë në mjedise të brendshme: tavane, mure dhe shpatulla të dyer-dritareve (ose kënde të mureve);
- Të suvatojë në mjedise të jashtme (fasada);

### **Punime shtrimi dyshemeje e veshje muri**

- Të shtrojë nënshtresat e dyshemeve të: katit përdhe, bodrumit që nuk përmytet dhe atij që përmytet;
- Të shtrojë shtresë niveluese dyshemeje;
- Të shtrojë dysheme me shtresa dhe materiale të ndryshme;
- Të veshë me pllaka muret e mjediseve sanitare;
- Të veshë me pllaka: shtyllat, bazamakët e shkallëve, davancalet dhe shpatullat e dyerve e dritareve;
- Të veshë mjediset e brendshme me shtresa të ndryshme;
- Të veshë fasadat me shtresa të ndryshme;

### **Punime konstruksionesh prej betoni dhe betoni të armuar**

- Të ndërtojë kallëpe për konstruksione të thjeshta prej betoni dhe betoni të armuar;

- Të lidhë shufrat e hekurit në kallëpe për konstruksione të thjeshta prej betoni të armuar;
- Të betonojë me krahë dhe makineri konstruksione të thjeshta prej betoni dhe betoni të armuar;
- Të trajtojë pas betonimit konstruksionet e thjeshta prej betoni dhe betoni të armuar;
- Të heqë kallëpet e konstruksioneve të thjeshta prej betoni të armuar;

#### **Punime patinimi e bojatisje**

- Të patinojë mure e tavane;
- Të kryejë bojatisje në sipërfaqe të ndryshme të brendshme e të jashtme;

#### **Punimet për mirëmbajtjen e ndërtesës**

- Të kryejë punime riparimi të hidroizolimit të tarracës, çatisë dhe të ullukëve horizontale dhe vertikale;
- Të kryejë punime riparimi të mureve të mjediseve të përbashkëta;
- Të kryejë punime riparimi të suvatimit të tavanit të kafazit të shkallëve;
- Të kryejë punime riparimi të suvatimit të mureve të mjediseve të përbashkëta;
- Të kryejë punime riparimi të bazamakëve të shkallëve dhe të davancaleve të parapetit të tarracës dhe të daljeve të ndryshme në tarracë;
- Të kryejë punime riparimi të dyshemeve të mjediseve të përbashkëta;
- Të kryejë punime riparimi të trotuarëve dhe të oborrit të shtruar;
- Të kryejë punime të bojatisjes në mjedise të përbashkëta të brendshme dhe të jashtme;
- Të kryejë punime për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimeve të ndërtesës;

#### **Punime elektrike të thjeshta dhe elektronike**

- Të komunikojë me korrektësi me banorët për probleme që lindin për shkak të defekteve të ndryshme.
- Të demonstrojë aftësi organizative për zgjidhjen e problemeve të ndryshme.
- Të zbatojë në kohë remontet e ndryshme të pajisjeve të nevojave të përbashkëta;
- Të identifikojë defektet e mundshme të rrjetit elektrik;
- Të konstatojë defektet e mundshme në elektropompa dhe ashensor;
- Të komunikojë me personat përgjegjës për riparimet e defekteve të mundshme;
- Të vendosë tabela me shenjat konvencionale për paralajmërimin dhe ruajtjen nga tensioni të personave të tjerë;
- Të çlirojë të dëmtuarin nga rryma elektrike dhe të japë ndihmën e shpejtë;

#### **Punime të thjeshta hidraulike e mekanike**

- Të identifikojë defektet e mundshme të rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë (hidrosanitare dhe të ngrohjes) të një ndërtese;
- Të identifikojë defektet e mundshme të rrjetit të brendshëm kanalizimit (hidrosanitare dhe të ngrohjes) të një ndërtese;
- Të identifikojë defektet e mundshme të rrjetit të ventilimit të një ndërtese;
- Të komunikojë me personat përgjegjës për riparimet e defekteve të mundshme.

## KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë qartë me shkrim e gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të arsyetuar këndvështrime mbi çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të dhënave të nevojshme për zhvillimin e tij vetjak dhe zejtar;
- Të nxisë aftësitë e tij të brendshme në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më të dobishme dhe më frytdhënëse për bashkësinë e banorëve;
- Të zotohet me trup, mendje e shpirt në kryerjen e detyrave të ndryshme në raste mjeshtrie, vetjake e shoqërore;
- Të nderojë ligjet dhe parimet e një bashkëjetese gjithëpërfshirëse (demokratike) në rrjedhat e përfshirjeve vendore e krahinore;
- Të rrëfejë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
- Të tregojë vetëpërmbytje gjatë ushtrimit të detyrave të tij/saj;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmëri e vullnet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë hapur në arritjen e synimeve të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga qasje të drejta si themel për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
- Të ilustrojë metoda të zgjidhjes së problemeve në kontekste të ndryshme;
- Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtejshme;
- Të përshkruajë konceptin e ndërmarrjeve me përgjegjësi sociale në kontekste lokale dhe globale;
- Të përshkruajë metodat e vlerësimit dhe vetëvlerësimit të aftësive profesionale;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari, aktivitete social-kulturale dhe komunitet;
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
- Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
- Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
- Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
- Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.